



Ftesë për ofertim për artikuj dhe afatet e kushtet e furnizimit

Data: 06.05.2022

Emri i pakos: Mbështetja me pako ushqimore per komunitetet Ashkali, Egjiptjan dhe Rom – Masa 3.4
Ministria e Financave

1. Ftoheni të dorëzoni ofertën tuaj të çmimeve për furnizim me artikullin në vijim (shihni specifikimin e hollësishëm të bashkëngjitur kësaj ftese):

Pakaja parashihet të përmbajë furnizimet ushqimore dhe higjienike.

Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Gjithsej Euro
<i>Pako ushqimore dhe higjienike</i>	<i>Sipas specifikacionit të dhënë në Aneksi 1: 1740 pako ushqimore / higjienike, pakaja përmban 20 artikuj</i>			

2. Ju duhet ta dorëzoni ofertën e kompletuar për artikullin e paraqitur në këtë ftesë. Oferta e çmimit do të vlerësohet në tërësi për artikullin dhe kontrata do t'i jepet kompanisë që ofron koston më të ulët të përgjithshme për artikullin.

3. Ofertat duhet të dorëzohen me email në adresën **office@balkansunflowers.org**.

4. Oferta e juaj duhet të jetë plotësisht në përputhje me afatet dhe kushtet e bashkëngjitura të furnizimit dhe duhet të shoqërohet me dokumentacionin e duhur teknik, materialin dhe informatat e tjera përkatëse të shtypura për secilin artikull të ofruar në ofertë, nëse kërkohen në afatet dhe kushtet e furnizimit.

5. Afati për pranimin e ofertës tuaj është: **13 Maj 2022, ora 17:00**, dhe hapja publike e ofertave të pranuar do të bëhet menjëherë.

6. Oferta juaj duhet të dorëzohet sipas udhëzimeve në vijim:

(i) **ÇMIMET:** Çmimet duhet të jepen në euro, përfshirë TVSH-në, kosto e dërgimit deri tek vendi i destinimit duhet të përfshihet në çmimin e pakos. Lokacionet e liferimit janë të elaboruara më poshtë:

Komuna e Fushë Kosovës (**1600 pako**), Graçanicës (**140 pako**).

Plani i shpërndarjes dhe i sasive bëhet në koordinim me Balkan Sunflowers Kosova.

60% e pakove duhet të shpërndahen në muajin Maj. 60% e pakove duhet të janë të gatshme për liferim më së largu deri me 21 Maj 2022 në ora 09:00.

40% e pakove shpërndahen në muajin qershor (më së largu me 10 qershor). 40% e pakove duhet të janë të gatshme për liferim më së largu deri me 7 qershor 2022 në ora 09:00

(ii) VLERËSIMI I OFERTAVE DHE LËSHIMI I URDHRIT PËR BLERJE (KONTRATA): Ofertat e përcaktuara si thelbësisht përgjegjëse ndaj specifikimeve teknike do të vlerësohen duke i krahasuar çmimet e tyre, llojinn dhe peshën e produkteve.

70% e produkteve duhet të janë produkte vendore (produkte me barkod 390). Do të përzgjidhet kompania e cila ofron çmimin e vlerësuar si çmimi më i ulët dhe produkti i së cilës përmbush standardet e kërkesave ushqimore dhe teknike.

(iii) VLEFSHMËRIA E OFERTËS: Oferta juaj duhet të jetë e vlefshme për një periudhë 30 ditore nga data e pranimit të ofertës të paraqitur në paragrafin 5 më lartë.

(iv) E DREJTA E BLERËSIT PËR TA NDRYSHUAR SASINË NË KOHËN E DHËNIES SË KONTRATËS. Blerësi e rezervon të drejtën për ta ulur apo rritur sasinë e mallit përkatës, sipas aneksit 1, dhe pa ndonjë ndryshim në çmimin për njësi ose në kushtet dhe afatet e tjera të FpO-s/ofertës.

7. Informatat shtesë mund të merren përmes emailit: office@balkansunflowers.org

AFATET DHE KUSHTET E FURNIZIMIT

8. Pjesët rezervë (nëse ka): duhen të përfshihen në ofertë.

Veglat dhe pajisjet përcjellëse (nëse ka): duhen të përfshihen në ofertë

Doracakët (nëse ka): aty ku është e nevojshme duhet të ketë udhëzues për përdorim

9. Çmimi fiks: çmimet e cekura në ofertë janë të pandryshueshme dhe fikse dhe nuk mund të përshtaten gjatë realizimit të kontratës.

10. Orari i dërgesës: Dërgesa duhet të kryhet në bazë të orarit të Urdhrit të blerjes (kontratës).

11. Pagesa e faturës përmes transferit bankar do të bëhet pas dërgesës së mallit.

Pagesat në avans nuk janë të lejuara.

12. Garancia: Mallrat e ofruara duhet të jenë të reja, freskëta, legale, të padëmtuara dhe të kenë garancinë e prodhuesit për së paku 3 muaj nga data e dërgesës tek blerësi. Luteni të saktësoni në hollësi periudhën e garancisë dhe kushtet e saj.

Specifikimet e kërkuara teknike

- i. Përshkrimi i përgjithshëm
- ii. Hollësitë specifike dhe standardet teknike
- iii. Parametrat e performancës

Furnitori konfirmon përputhjen me specifikacionin e dhënë në aneksin 1.

14. Dështimi në përmbushje të kontratës: Blerësi mund ta anulojë urdhrin për blerje nëse furnitori nuk e dërgon mallin në përputhje me afatet dhe kushtet e lartshënuara, përkundër njoftimit paraprak prej 5 ditësh, të dhënë nga blerësi, pa shkaktuar ndonjë obligim ndaj furnitorit.

Me nderime,

Emri i organizatës	Balkan Sunflowers Kosova
Adresa	Rr: Bajram Kelmendi 31, Prishtinë, Kosovë
Data e dërgimit	06.05.2022



Aneks 1

Pakoja përmban 20 artikuj ushqimorë dhe higjienikë (pako e paketimit është pjesë e artikujve dhe duhet të sigurohet nga ofertuesi). Gjithsej janë 1740 pako. Pakoja duhet të jetë e mbyllur mirë, e siguruar prej dëmeve eventuale gjatë transportit / liferimit në destinacionet e cekura. Secilës pako duhet t'i vendoset tiketa ngjitëse e cila ofrohet nga Balkan Sunflowers Kosova.

Vërejtje: Forma e Aneks 1 mund të përdoret si form për ofertim. Kompanit mund të përdorin format e vete të standardizuara të cilat duhet ti përmbajnë informatat e kërkuara nga Aneks 1.

#	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Pesha për sasi (gr, ml)	Prodhuesi	Çmimi për njësi	Çmimi total
1	Vaj ushqimor	Copë	2				
2	Sheqer (1 kg)	Copë	2				
3	Kripë (1 kg)	Copë	2				
4	Vegetë, paketimi	Copë	1				
5	Qaj, paketimi	Copë	1				
6	Makarona, paketimi	Copë	2				
7	Qumësht	Litra	2				
8	Fide, paketimi	Copë	1				
9	Biber kuq, paketimi	Copë	1				
10	Oriz	Copë	2				
11	Pasul, paketimi	Copë	2				
12	Patate	Copë	1				
13	Qepë	Copë	1				
14	Miell 25 kg	Copë	1				
15	Peceta higjienike (për menstruacione)	Copë	1				
16	Shampon për flokë	Copë	1				
17	Shampon për duar	Copë	1				
18	Shampon për pastrim të enëve	Copë	1				
19	Domestos	Copë	1				
20	Paketa per paketimin e pakos	Copë	1				
Çmimi për një pako							

Emërtim i pakos	Sasia	Çmimi për një pako	Çmimi total për 1740 pako
Pako ushqimore dhe higjienike	1740		

Emri i kompanisë: _____

Nënshkrimi personit të autorizuar: _____

Data: _____

Vula e kompanisë:

Emaili kompanisë: _____

Telefoni: _____